



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2017 – Numri: 251

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 21 maj 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 670, datë 29.12.2017	13563
Për hapjen në Republikën e Shqipërisë të degës së institucionit të arsimit të lartë të huaj <i>Ecole pour l'Informatique et les Nouvelle Technologies "Epitech"</i> , me seli qendrore në Republikën e Francës.....	13563



URDHËR

Nr. 670, datë 29.12.2017

**PËR HAPJEN NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË TË DEGËS SË
INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË
TË HUAJ *ECOLE POUR
L'INFORMATIQUE ET LES NOUVELLE
TECNOLOGIES "EPITECH", ME SELI
QENDRORE NË REPUBLIKËN
E FRANCËS***

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 7 dhe 29, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të pikës 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 418, datë 10.5.2017, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e IAL-ve dhe degëve të tyre",

URDHËROJ:

1. Hapjen në Republikën e Shqipërisë të degës së institucionit të arsimit të lartë të huaj *Ecole pour l'Informatique et les Nouvelle Technologies "EPITECH"*, me seli qendrore në Republikën e Francës, adresa: 24. Rue Pasteur, 94270 Le Kremlin-Bicetre, Paris.

2. Dega e institucionit të arsimit të lartë të huaj "EPITECH", me emërtimin "EPITECH Albania", do të jetë departamenti i "Ekspert i Teknologjisë së Informacionit", si njësi bazë e Fakultetit të "Ekspert i Teknologjisë së Informacionit", të këtij institucioni.

3. Dega "EPITECH Albania", pjesë përbërëse e institucionit të arsimit të lartë të huaj "EPITECH", do të ushtrojë veprimtarinë e saj në adresën: Rruga e Rinasit, Tërana Biznes Park (TBP), ndërtesa 7, Tiranë.

4. Dega "EPITECH Albania", pjesë përbërëse e institucionit të arsimit të lartë të huaj "EPITECH", do të ofrojë programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë, të organizuara sipas kërkesave të përcaktuara në kreun VII, "Organizimi i studimeve në IAL", të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë".

5. Në përfundim të realizimit të programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë, institucioni i arsimit të lartë të huaj "EPITECH" lëshon diplomë të ciklit të parë *Bachelor* në "Teknologjinë e informacionit" dhe diplomë të ciklit të dytë master i shkencave "Ekspert i Teknologjisë dhe Informacionit".

6. Pikat 1, 3 dhe 4 të urdhrit të MAS-it nr. 326, datë 8.6.2017, "Për hapjen me kusht të filialit të institucionit të huaj të arsimit të lartë "EPITECH Albania", si njësi kryesore e këtij institucioni në Republikën e Shqipërisë", shfuqizohen.

7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe institucioni i arsimit të lartë të huaj "EPITECH Albania".

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Lindita Nikolla

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 28 lekë